



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 129

Tiranë – E hënë, 10 shtator 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10869, datë 27.8.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	8841
Dekret i Presidentit nr. 10870, datë 27.8.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8841
Dekret i Presidentit nr. 10871, datë 3.9.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8841
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 625, datë 27.8.2018	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar”.....	8842
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 626, datë 27.8.2018	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar.....	8842
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 627, datë 27.8.2018	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar”.....	8843
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 629, datë 27.8.2018	Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal.....	8843
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 632, datë 29.8.2018	Për miratimin e listës së sëmundjeve infektive, të detyrueshme për t’u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike ose private të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë.....	8844

Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 9 datë 4.9. 2018	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”.....	8849
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 957/7, datë 27.8.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i qendrës së qytetit Çorovodë”, faza e dytë, Bashkia Skrapar.....	8855
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hekuran Arixhiu.....	8856

**DEKRET****Nr. 10869, datë 27.8.2018****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Kreshnik Skender Xhangolli
2. Alba Serri Sulaj
3. Armando Zevxhet Stonja
4. Arsind Armando Stonja
5. Nenci Adelajd Bardhyl Hogu
6. Ervin Qemal Kamberaj
7. Denada Aleksandër Sema
8. Rikard Ilir Fusha
9. Ilir Vasil Kaçi
10. Erisa Jorgo Luma (Tale)
11. Blerina Kujtim Bevapi
12. Eglantina Sefe Rashkaj (Krasniqi)
13. Lorik Xhemë (Gjeme) Rashkaj
14. Havjola Xhemë (Gjeme) Rashkaj
15. Armand Muhamet Mema
16. Kristina Menellao Kuremeno
17. Iva Nehat Melani
18. Klaus Llambi Risto
19. Sokol Tomor Zyla
20. Esmeralda Adhurim Shametaj
21. Denada Haki Nano (Hoti)
22. Erald Ramazan Kumrija
23. Ornela Sami Uruçi
24. Armand Shpëtim Hoxha
25. Ada Naim Alijaj (Aligiai)
26. Argjend Skender Luzha
27. Xhensila Maksim Dani
28. Kristela Sokol Lucaj
29. Rozana Lutfi Prusha (Pashaj)
30. Jodranka (Jodrankë) Bllago Raičević (Matanaj)
31. Marsela Hekuran Xhaferaj
32. Ervisa Flamur Spahiu
33. Ema Maliq Dumani
34. Irena Mark Halimi (Hasani)

35. Gentian Jollmas Halimi
36. Erjon Jollmas Halimi
37. Ervis Fari Xhediku
38. Adela Nazmi Gaba (Allushi)
39. Fatjon Idriz Kuliçi
40. Ledio Astrit Kuliçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 10870, datë 27.8.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sali Rifat Zeka
2. Asije Ali Zeka (Krasniqi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 10871, datë 3.9.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,



DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë, personit të mëposhtëm:

1. Ekrem Kurtesh Lluka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 625, datë 27.8.2018

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31,
DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK”, TË
NDRYSHUAR”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 11.070 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 365, datë 21.9.2017, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2018.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM

Nr. 626, datë 27.8.2018

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618,
DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 11.070 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



4. Udhëzimi nr. 366, datë 21.9.2017, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2018.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM

Nr. 627, datë 27.8.2018

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 11.965 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Udhëzimi nr. 367, datë 21.9.2017, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2018.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM

Nr. 629, datë 27.8.2018

MBI PËRCAKTIMIN E MASËS PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pikave 2, 3, 16 dhe 17, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Paga bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2 të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, është 10,575 (dhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 6.345 (gjashtë mijë e treqind e dyzetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “b”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 8.460 (tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “c”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 10.575 (dhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “ç”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 12,690 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj



për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “d”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 4,759 (katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “dh”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 6,346 (gjashtë mijë e treqind e dyzet e gjashtë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

8. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “e”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 7,931 (shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

9. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “ë”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 9,517 (nëntë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

10. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 12,690 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

11. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet e herëpashershme të ndihmësit personal, është 8,460 (tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

12. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

13. Udhëzimi nr. 22, datë 7.10.2016, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 632, datë 29.8.2018

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE, TË
DETYRUESHME PËR T’U RAPORTUAR
NGA INSTITUCIONET
SHËNDETËSORE, PUBLIKE OSE
PRIVATE TË TË GJITHA NIVELEVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5, pika 1 të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar dhe të nenit 29, pika 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së sëmundjeve infektive, të detyrueshme për t’u raportuar nga institucionet shëndetësore publike ose private të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë (sipas listës bashkëlidhur).

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



LISTA E SËMUNDJEVE INFEKTIVE,
SHKAKTARËVE TË TYRE DHE
SINDROMAVE PÛRKATËSE, TË CILAT
DUHET DETYRIMISHT TË RAPORTOHEN
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

A. Lista e sëmundjeve infektive dhe shkaktarëve të tyre

1. AIDS* dhe HIV (sindroma e imunodeficiencës së fituar dhe infeksion me virusin e imunodeficiencës humane) (virusi i imunodeficiencës humane)

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

2. Amebiazë (*Entamoeba spp.*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

3. Antraks (*Bacillus anthracis*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

4. Borelioze ose sëmundja Lyme (*Borrelia spp.*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit dhe survejancës laboratorike.

5. Botulizëm (*Clostridium botulinum*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

6. Bruceloze (*Brucella spp.*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

7. Ciklosporiazë (*Cyclospora cayentanensis*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

8. Difteri (*Corynebacterium diphtheriae*, *Corynebacterium ulcerans* dhe *Corynebacterium pseudotuberculosis*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

9. Encefalit (përfshi këtu dhe encefalitin e transmetuar nga rriqnat –TBEV)**

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit dhe survejancës bazuar në ngjarje.

10. Ekinokokozë (*Echinococcus granulosus*, *Echinococcus multilocularis*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit dhe survejancës laboratorike.

11. Ethe butonoze/Ethe mesdhetare (*Rickettsia conorii*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

12. Ethe Çikungunia (virusi Chikungunya)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

13. Ethe Dengue (virusi Dengue)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

14. Ethe e verdhë (virusi i ethes së verdhë)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

15. Ethe hemorragjike e Kongo-Krimesë (virusi i Ethes hemorragjike të Kongo-Krimesë)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

16. Ethe hemorragjike me sindromë renal (Hantaviruse)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

17. Ethe hemorragjike të tjera (Lassa, Marburg etj.)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

18. Ethe Q (*Coxiella burnetii*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

19. Fruth (virusi i fruthit)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

20. Grip (virusi i gripit A, B dhe C)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

21. Grip i shpendëve apo i kafshëve të tjera te njerëzit (AH5, AH5/N1, AH7/N9 etj.)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

**22. Grip pandemik** (*virusi i gripit A pandemik*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

23. Helmim ushqimor

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit dhe survejancës bazuar në ngjarje.

24. Hepatit viral A (*virusi i hepatitit A*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

25. Hepatit viral B (*virusi i hepatitit B*)

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

26. Hepatit viral C (*virusi i hepatitit C*)

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

27. Hepatit viral D (Delta) (*virusi i hepatitit delta*)

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

28. Hepatit viral E (*virusi i hepatitit E*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

29. Infeksion herpetik neonatal dhe genital

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

30. Infeksion nga gonokokou si gonorrhe etj. (*Neisseria gonorrhoeae*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

31. Infeksion nga klamidia përfshi këtu edhe Limfograduloma venereum (LGV) (*Chlamydia trachomatis*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

32. Infeksion nga virusi i Nilit Perëndimor (virusi i etheve të Nilit Perëndimor)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

33. Infeksion nozomial (infeksion i lidhur me kujdesin shëndetësor)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

34. Infeksion nga Escherichia coli prodhues i toksinës Shiga dhe/ose verocito-toksinës (STEC/VTEC, EHEC), Sindrom uremik hemolitik (*Escherichia coli*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

35. Infeksion nga Escherichia coli invaziv (*Escherichia coli*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

36. Infeksion nga Rotavirus (*Rotavirus*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës sentinel dhe asaj laboratorike.

37. Infeksion streptokoksik i grupit A (Celulit, Erizipelë, Fascit Nekrotizues, Meningit, Sepsis, Sindromë e Shokut Toksik, Skarlatine)

Raportohet menjëherë brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

38. Jersiniozë (*Yersinia enterocolitica*, *Yersinia pseudotuberculosis*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

39. Kampilobakteriozë (*Campylobacter spp.*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

40. Kolerë (*Vibrio cholerae*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

41. Kriptosporidiozë (*Cryptosporidium spp.*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

42. Legjionelozë (sëmundje e legjionarëve) (*Legionella spp.*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

43. Leishmaniozë kutane (*Leishmania spp.*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

44. Leishmaniozë viscerale (*Leishmania spp.*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së



rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

45. Leptospirozë (*Leptospira* spp.)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

46. Listeriozë (*Listeria monocytogenes*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

47. Malarie (*Plasmodium* spp.)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

48. Meningit aseptik

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

49. Meningit bakterial

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

50. Murtajë (*Yersinia pestis*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

51. Parazitë intestinale (*Nematodes* spp.)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

52. Parotit viral (shytat) (virusi i parotitit viral)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

53. Pertusis (kolla e mirë) (*Bordetella pertussis*)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

54. Poliomieli (virusi Polio)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

55. Rezistencë antimikrobike

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

56. Rubeolë (përfshi këtu Rubeolën kongenitale dhe sindromën e Rubeolës kongenitale) (virusi i rubeolës)

Raportohet menjëherë brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

57. Salmonelozë (*Salmonella* spp. të ndryshme nga *Salmonella typhi* dhe *Salmonella paratyphi*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

58. SARS* - Sindromi akut respirator i rëndë** (SARS-coronavirus, SARS-CoV)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

59. Sëmundje Creutzfeldt – Jakob, varianti CJD (vCJD)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

60. Sëmundje e shkaktuar nga virusi Ebola (viruset Ebola spp.)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

61. Sëmundje e shkaktuar nga virusi Zika (virusi Zika)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

62. Sëmundje invasive nga Haemophilus influenza (*Haemophilus influenza*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

63. Sëmundje meningokoksike invazive (*Neisseria meningitidis*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

64. Sëmundje pneumokoksike invazive (*Streptococcus pneumonia*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

65. Sifiliz (përfshi këtu Sifilizin kongenital dhe atë neonatal) (*Treponema pallidum*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

66. Sindromë Respiratore e Lindjes së Mesme (MERS)** (MERS Co-V)**

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.



67. **Shigelozë (Dizanteri bakteriale)** (*Shigella spp.*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

68. **Tetanoz** (*Clostridium tetani*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

69. **Tërbim (Rabies)** në njerëz apo kafshë (*Lyssa virus*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

70. **Tifo abdominale (Ethe tifoide dhe paratifo)** (*Salmonella typhi/paratyphi*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

71. **Tifo murine** (*Rickettsia typhi*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

72. **Toksoplazmozë (përfshi këtu Toksoplazmozën kongenitale)** (*Toxoplasma gondii*)

Raportohet brenda 3 ditëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

73. **Trikinelozë** (*Trichinella spp.*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

74. **Tuberkuloz** (*Mycobacterium tuberculosis complex*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

75. **Tularemi** (*Francisella tularensis*)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

76. **Varicelë** (virusi i varicela – Zoster, VZV)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

77. **Variolë** (virusi i varioles)

Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje.

78. **Xhiardiazë** (*Giardia lamblia*)

Raportohet brenda 7 ditëve nëpërmjet survejancës laboratorike.

B. Lista e sindromave të përgjithshme të lidhura me sëmundjet infektive.

B.1 Sindroma të cilat duhet të raportohen menjëherë brenda 24 orëve

1. Ethe dhe hemorragji
2. Infeksion respirator i rëndë akut (IRRA)
3. Insuficiencë renale akute me ose pa një infeksion apo gjendje febrile
4. Paralizë flaksid akute (PFA)
5. Rash me temperaturë
6. Reaksion anësor pas vaksinimit
7. Sëmundje e rëndë e pashpjeguar që çon në vdekje të papritur

8. Sëmundje respiratore e ngjashme me gripin (ILI*****) (vetëm për qendrat sentinel)

9. Sindrom meningeal
10. Sindrom uremik hemolitik
11. Të vjella profuze akute

B.2 Sindroma të cilat duhet të raportohen brenda javës (7 ditëve)

1. Anomali kongenitale
2. Diarre akute me gjak
3. Gastroenterit/diarre akute pa gjak
4. Infeksion respirator i poshtëm
5. Infeksion respirator i sipërm
6. Konjuktivit akut te neonatët
7. Ethe e zgjatur e pashpjeguar (më shumë se tri javë)
8. Verdhëz

C. Ngjarjet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare

C.1 Ngjarje të cilat duhet të raportohen menjëherë brenda 24 orëve

1. Ngjarje të lidhura me grumbullim rastesh
2. Ngjarje të lidhura me shpërthime epidemike
3. Ngjarje të lidhura me rrezikun për shpërthime epidemike apo të tjera (sëmundje në kafshë, ndotje mjedisore etj.)

4. Ngjarje të lidhura me sëmundje me rëndësi ndërkombëtare sipas aneksit 2 të Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

C.1 Ngjarje të cilat duhet të raportohen brenda javës (7 ditëve)

1. Zgjebe
 2. Evidentimi i morrit të kokës dhe trupit etj.
 3. Dermatofiti
- Sqarime:



* **AIDS** nga gjuha angleze: Acquired Immunodeficiency Syndrome

** **TBEV** nga gjuha angleze: Tick Borne Encephalitis Virus

*** **SARS** nga gjuha angleze: Severe Acute Respiratory Syndrome

**** **MERS** nga gjuha angleze: Middle East Respiratory Syndrome

***** **ILI** nga gjuha angleze: Influenza Like Illness

VENDIM

Nr. 9, datë 4.9.2018

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, KDZH, i ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mbledh në datën 31.8.2018, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Dokumentacionit pas Vitit 1944,

VENDOSI:

